

OBSERVATORI I EKONOMIVE TË PALIGJSHME NË EVROPËN JUGLINDORE

NUMRI

10 TETOR-NËNTOR 2021

Përmbledhje e pikave kryesore



Vendet e Ballkanit dalin me rezultate të dobëta në Indeksin Global të Krimit të Organizuar për vitin 2021.

Rezultatet e Indeksit Global të Krimit të Organizuar, nga Iniciativa Globale Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (GI-TOC - Global Initiative Against Transnational Organized Crime), tregojnë se vendet e Ballkanit Perëndimor, në aspektin e kriminalitetit, arrijnë pikë më të larta sesa mesatarja globale. Në fakt, katër prej gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor (WB6) bëjnë pjesë në 10 vendet me pikët më të larta në Evropë për sa i përket kriminalitetit. Rajoni pasqyron edhe prirjen globale të nënvizuar në Indeks, sipas së cilës aktorët e lidhur me shtetin janë tipi më dominues i aktorit kriminal në botë. Megjithatë, vendet e rajonit në përgjithësi kanë arritur pikë më të larta sesa mesatarja botërore edhe në aspektin e aftësisë së shtetit për të luftuar krimin e organizuar.



Rrëzimi i mitit të ekzistencës së një karteli ballkanik.

Media dhe agjencitë e zbatimit të ligjit, duke përfshirë edhe Europolin, shpesh ia kanë atribuar kriminalitetin në rajon "kartelit ballkanik". Megjithatë, edhe pse në rajon

ekzistojnë modele të qarta të bashkëpunimit ndëretnik midis grupeve kriminale, nuk ka tregues që këto grupe janë pjesë e një strukture të ngjashme me atë të karteleve.



Përdorimi i kriptovalutave po fillon të marrë hov në rajon.

Rritja e përdorimit të kriptovalutave në Ballkanin Perëndimor sjell mundësi të reja, por edhe rreziqe të tjera siç është pastrimi i parave. Ne shqyrtojmë mënyrën se si funksionojnë kriptovalutat, japim shembuj të nxjerrjes së kriptovalutave ("cryptomining") dhe ndalemi më hollësisht te sfidat me të cilat rajoni po fillon të përballet, sidomos në lidhje me kriptovalutat si element i prurjeve financiare të paligjshme.



Ndërtimi i urave midis shoqërisë civile dhe qeverisë në Maqedoninë e Veriut.

Observatori i Ekonomive të Paligjshme në Evropën Juglindore aktualisht është duke zhvilluar një sërë dialogësh rreth qëndrueshmërisë në secilin prej gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor. Në këtë artikull diskutohet takimi i zhvilluar në Shkup dhe nënvizohen sfidat dhe mundësitë që paraqet forcimi i bashkëpunimit



midis shoqërisë civile dhe qeverisë në drejtim të parandalimit dhe luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.



“Shkapja” e shtetit: Intervistë me OJQ-në maqedonase “Eurothink”.

Maqedonia e Veriut ka një shoqëri civile aktive, e cila merret me shumë problematika, duke përfshirë këtu edhe

problematikat e ndërlidhura me krimin e organizuar dhe korrupsionin. Bisedojmë me organizatën “Eurothink - Qendra për Strategji Evropiane”, një prej organizatave kryesore joqeveritare në vend, në lidhje me objektivat dhe aktivitetet e saj dhe përqendrimin e saj te krimi mjedisor.

RRETH KËTIJ NUMRI

Mirë se vini në numrin e dhjetë të “Buletinit të rreziqeve”, i cili botohet nga Observatori i Ekonomive të Paligjshme në Evropën Juglindore të GI-TOC-së. Në këtë numër, analizojmë gjetjet kryesore të GI-TOC-së lidhur me Ballkanin në Indeksin Global të Krimit të Organizuar, i pari i këtij lloji. Për një analizë më të hollësishme, duke përfshirë edhe profilet e të gjitha vendeve të rajonit, jeni të lutur të vizitoni faqen: ocindex.net.

Gjatë hulumtimit tonë në lidhje me ekonomitë e paligjshme në Evropën Juglindore, herë pas here kemi ndeshur shprehjen “kartel ballkanik”. Edhe pse grupet kriminale të Ballkanit Perëndimor janë bërë më ndërkombëtare dhe, në disa raste, më të fuqishme gjatë viteve të fundit, sipas nesh, ato nuk janë të bashkuara, ashtu siç lë media të kuptohet. Për këtë arsye, ne e shqyrtuam këtë term dhe origjinën e mitit dhe konstatuam se situata është më e ndërlikuar sesa përfytyrimi i grupeve kriminale të Ballkanit si oktapod gjigant me udhëheqës të përcaktuar që kontrollojnë tentakulat.

Tani për tani, kriptovalutat janë në modë. Çmimi i bitkoinit (“Bitcoin”) ka arritur nivele rekord me mbi 55 000 euro për njësi, por gjithashtu ekziston edhe një debat në rritje lidhur me rregullimin e kriptovalutave. Në punën tonë lidhur me prurjet financiare të paligjshme dhe me analizimin e konfiskimit të aseteve, kemi parë, gjithmonë e më shumë, referenca lidhur me përdorimin e kriptovalutave nga grupet kriminale në dhe nga Ballkani Perëndimor. Deri më tani, përdorimi i kriptovalutave në rajon është relativisht i kufizuar. Megjithatë, kjo është një problematikë të cilës duhet t’i kushtohet vëmendje, sidomos nga hetuesit financiarë në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor (WB6).

Falë financimit nga partnerët tanë financues, ku përfshihen Gjermania, Norvegjia dhe Holanda, kemi mundur të

mbështesim organizatat e shoqërisë civile në Evropën Juglindore, të cilat janë duke kryer aktivitete në drejtim të përmirësimit të qëndrueshmërisë ndaj krimit të organizuar. Një pjesë e kësaj pune përfshin një varg dialogësh për qëndrueshmërinë ndaj krimit të organizuar në secilin prej gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor. Takimi i parë u zhvillua në Shkup në datat 22 dhe 23 shtator 2021 dhe pesë të tjerë do të zhvillohen deri në fillim të dhjetorit.

Do të nxirren disa raporte tematike lidhur me disa prej çështjeve kryesore të trajtuara në dialogë dhe projektet e realizuara nga organizatat e shoqërisë civile (OSHC) në rajon, domethënë rinia, çështjet gjinore dhe ripërdorimi social i aseteve. Në këtë buletin, raportojmë lidhur me dialogët për qëndrueshmërinë që kemi organizuar në Shkup, në veçanti lidhur me përpjekjet për fuqizimin e bashkëpunimit midis shoqërisë civile dhe qeverisë.

Ndërkohë që ishim në Shkup, intervistua dy drejtues të OJQ-së “Eurothink - Qendra për Strategji Evropiane” në kuadër të fokusit tonë të përmuajshëm mbi OSHC-të që punojnë për rritjen e qëndrueshmërisë ndaj krimit të organizuar. Në punën e tyre, organizatat përqendrohen sidomos në fuqizimin e zbatimit të kapitullit 24 të **acquis**-it të BE-së në Maqedoninë e Veriut, kapitull ky që ka të bëjë me drejtësinë, lirinë dhe sigurinë.

Në fund të këtij numri reviste, paraqesim një vështrim të përgjithshëm të publikimeve të kohëve të fundit që kanë të bëjnë me krimin e organizuar dhe korrupsionin në Ballkanin Perëndimor dhe paraqesim raportet e reja dhe të ardhshme nga GI-TOC-ja.

Nëse dëshironi të sugjeroni ndonjë histori ose të bëni komente, jeni të lutur të na kontaktoni në adresën e emailit: almedina.dodic@globalinitiative.net.

1. Vendet e Ballkanit dalin me rezultate të dobëta në Indeksin Global të Krimit të Organizuar për vitin 2021.

Më 28 shtator 2021, GI-TOC-ja publikoi Indeksin Global të Krimit të Organizuar, rezultat i hulumtimeve disavjeçare ku morën pjesë mbi 350 ekspertë nga e gjithë bota dhe që mbulon të 193 vendet anëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Bazë e Indeksit është analiza e thellë e tregjeve kriminale dhe aktorëve kriminalë. Sipas nivelit të tij të kriminalitetit, çdo vend vlerësohet me një notë nga 1 në 10, ku 1-shi nënkupton një tip tregu ose aktori që ose nuk ekziston ose është i papërfillshëm për nga ndikimi që ka, ndërsa 10-a nënkupton që nuk ka asnjë aspekt të shoqërisë që nuk është prekur nga krimi i organizuar.

Indeksi mat edhe qëndrueshmërinë e vendit ndaj krimit të organizuar, domethënë aftësinë e aktorëve shtetërorë dhe joshetërorë për t'i bërë ballë dhe shkatërruar veprimtaritë e krimit të organizuar si tërësi, dhe jo tregjet individuale, nëpërmjet marrjes së masave politike, ekonomike, ligjore dhe sociale. Edhe këtu, shteteve u jepet një notë që varion nga 1 në 10, por në këtë rast shkalla është e përmbytur: njëshi nënkupton mungesën e mekanizmave të përshtatshëm të qëndrueshmërisë ndërsa dhjeta nënkupton praninë e masave tepër efektive për të luftuar krimin e organizuar dhe ndikimin e tij.

Vlerësimi i nivelit të kriminalitetit në lidhje me nivelet e qëndrueshmërisë, dhe jo fokusimi vetëm te përhapja e ekonomive të paligjshme dhe tek aktorët kriminalë, siguron kushtet për analizimin e cenueshmërisë përmes lenteve shumëdimensionale. Për shembull, një vend si Maqedonia e Veriut mund të ketë notë relativisht të lartë kriminale (5,31 krahasuar me mesataren globale që është 4,88), por kjo zbutet pjesërisht nga nota relativisht e lartë e qëndrueshmërisë (5,21 krahasuar me mesataren globale që është 4,82).

Serbia, Mali i Zi dhe Bosnja dhe Hercegovina zënë, respektivisht, vendin e dytë (pas Rusisë), të katërt dhe të pestë, në renditjen e kriminalitetit për të gjithë Evropën. Problemet e Malit të Zi përbëhen nga një notë relativisht e ulët e qëndrueshmërisë (4,46), ndërkohë që Bosnja dhe Hercegovina ka një prej notave më të ulëta të qëndrueshmërisë në të gjithë Evropën (3,92) dhe

renditet e 138-a në botë në aspektin e qëndrueshmërisë ndaj krimit të organizuar.

Panorama është disi më e mirë për vendet e Evropës Juglindore të cilat janë anëtare të Bashkimit Evropian. Sllovenia, Kroacia dhe Rumania arritën rezultate relativisht të larta në aspektin e qëndrueshmërisë, ndërkohë që pjesa më e madhe e vendeve të BE-së nga rajoni kanë nivele relativisht të ulëta të kriminalitetit. Bullgaria përbën përjashtim meqenëse është vlerësuar me notën 5,43 në aspektin e kriminalitetit, çka e vendos këtë vend në vendin e 10-të në Evropë.


Meqenëse Kosova nuk është anëtare me të drejta të plota në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, ajo nuk është përfshirë zyrtarisht në Indeks në kuadër të renditjes së vendeve. Pavarësisht kësaj, Kosova u shqyrtua me po aq imtësi sa edhe vendet e tjera dhe u vlerësua gjatë raundeve të ndryshme të verifikimit që qëndrojnë në thell të instrumentit vlerësues. Pra Kosova* u vlerësua me notën 5,19 në aspektin e kriminalitetit (më i ulëti në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor) dhe me notën 4,42 në aspektin e qëndrueshmërisë, vlerësim ky relativisht i ulët (çka e bën këtë vend të zërë vendin e dytë pas Bosnjës dhe Hercegovinës).

Edhe pse Kosova ka vendosur kanale alternative të bashkëpunimit ndërkombëtar, fakti që vendi nuk njihet zyrtarisht ndikon në kufizimin e mekanizmave të disponueshëm të bashkëpunimit në drejtim të luftës kundër krimit të organizuar.

Indeksi u mundëson përdoruesve që të identifikojnë edhe karakteristikat dhe prirjet rajonale. Për shembull, në Ballkan, notat e larta për kriminalitetin kanë të bëjnë me kontrabandimin e njerëzve dhe trafikimin e heroinës, të cilat, të dyja, arrijnë një mesore mesatare prej 6,25 për gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, çka është konsiderueshëm më e lartë sesa mesorja kontinentale prej notave 4,73 dhe 4,41 respektivisht, ndërkohë që notat për trafikimin e kanabisit (5,91) dhe kokainës (5,66) janë më të larta sesa mesorja e Evropës me notat 0,81 dhe 0,84 respektivisht.



Vendi	Kriminaliteti	Renditja (në Evropë)	Renditja (globale)
Serbia	6,21	2 (44)	33 (193)
Mali i Zi	6,00	4 (44)	45 (193)
Bosnja dhe Hercegovina	5,89	5 (44)	49 (193)
Shqipëria	5,63	9 (44)	61 (193)
Bullgaria	5,43	10 (44)	70 (193)
Maqedonia e Veriut	5,31	11 (44)	74 (193)
Kosova*	5,19	-	78 (193)
Kroacia	5,06	13 (44)	85 (193)
Greqia	4,93	14 (44)	92 (193)
Rumania	4,59	22 (44)	115 (193)
Slovenia	4,29	29 (44)	132 (193)



Vendi	Qëndrueshmëria	Renditja (në Evropë)	Renditja (globale)
Slovenia	6,08	25 (44)	36 (193)
Kroacia	5,58	26 (44)	51 (193)
Rumania	5,58	26 (44)	51 (193)
Bullgaria	5,29	30 (44)	71 (193)
Greqia	5,25	31 (44)	72 (193)
Maqedonia e Veriut	5,21	32 (44)	76 (193)
Shqipëria	5,04	36 (44)	87 (193)
Serbia	4,92	37 (44)	93 (193)
Mali i Zi	4,46	38 (44)	112 (193)
Kosova*	4,42	-	114 (193)
Bosnja dhe Hercegovina	3,92	42 (44)	138 (193)

FIGURA 1 Rezultatet për kriminalitetin dhe qëndrueshmërinë e vendeve të Ballkanit në Indeksin Global të Krimit të Organizuar për vitin 2021.

SHËNIM: *Referencat për Kosovën në Indeks janë bërë pa cenuar pozicionet lidhur me statusin e vendit dhe janë në përputhje me Rezolutën 1244/1999 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe me opinionin këshillimor të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë lidhur me shpalljen e pavarësisë nga Kosova.

Indeksi Global i Krimit të Organizuar, GI-TOC, ocindex.net

Një prej gjetjeve më shqetësuese të Indeksit është që aktorët e lidhur me shtetin janë tipi më dominues kriminal në botë. Shkalla në të cilin kriminaliteti depërton

në institucionet shtetërore varion nga korrupsioni në nivele të ulëta e deri te kapja e plotë e shtetit, por në të

gjithë spektrin e tij, ky depërtim ka pasojë në aftësinë e shteteve për të reaguar ndaj krimit të organizuar.

Ndonëse ky rrezik është relativisht i ulët në Evropën Perëndimore, nota mesatare për aktorët e lidhur me shtetin në Evropën Qendrore dhe Lindore arrin në 6,76 (kjo notë arrin kulmin me vlerën 8 në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në Serbi). Kjo është alarmuese, sepse një prej bashkëshoqërimeve më të fuqishme që dalin nga Indeksi u gjet se qëndron midis pranisë së aktorëve kriminalë që kanë lidhje me shtetin dhe qëndrueshmërisë së dobët, çka lë të kuptohet se këta aktorë mund të jenë duke e minuar kapacitetin dhe aftësinë së shtetit për të parandaluar prurjet e paligjshme.

Edhe pse Indeksi përbën matjen e parë botërore të krimit të organizuar, ai nuk është projektuar për të mos qenë tjetër veçse një instrument kërkimor krahasues. Qëllimi i Indeksit është të sigurojë informacione të mbështetura në metrikë, të cilat u mundësojnë politikëbërësve, praktikuesve dhe palëve të tjera të interesuara që të informohen më mirë gjatë procesit të hartimit të strategjive për luftën ndaj krimit të organizuar në vendet dhe/ose rajonet e tyre. Pritet që ky Indeks të përditësohet çdo dy vjet.

Për të lexuar raportin e plotë dhe për të parë profilet e secilit vend veç e veç, vizitoni faqen: ocindex.net.

2. Rrëzimi i mitit të ekzistencës së një karteli ballkanik.

“Karteli kriminal” është aleancë e sofistikuar e shumë organizatave dhe grupeve kriminale që bashkëpunojnë për një kohë të gjatë nën drejtimin e disa shefave dhe një “mbreti” dhe ka lidhje të shtrira me kriminelë të tjerë të organizuar në nivelin kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar. Media dhe agjencitë e zbatimit të ligjit, duke përfshirë edhe Europolin, ndonjëherë flasin për ekzistencën e një “karteli ballkanik”. A është ky kartel mit apo ekziston vërtet një organizatë e tillë kriminale? Dhe pse paraqet rëndësi diçka e tillë? ¹

Burimi kryesor i të ardhurave të karteleve është trafikimi i drogës.² Ato prodhojnë, transportojnë dhe shpërndajnë drogë të paligjshme me ndihmën e organizatave kriminale që janë ose anëtare të kartelit ose bashkëpunojnë me të ngushtësisht. Gjithashtu, ato bëjnë larjen e parave që vijnë nga trafikimi i drogës.

Disa prej shembujve historikë përfshijnë kartelin e Medelinit, nën drejtimin e Pablo Eskobarit ose kartelin separatist të Kalit, të dy në Kolumbi. Disa prej shembujve bashkëkohorë janë karteli i Sinaloas, karteli i Gjirit [të Meksikës] ose karteli i Huarezit në Meksikë, të cilët realizojnë shpërndarjen e drogës nëpërmjet celulave në qytete anëmbanë Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe që raportojnë te drejtuesit në Meksikë ose drejtpërdrejt ose tërthorazi nëpërmjet ndërmjetësve. Këto kartelevë përbëhen nga celula të ndryshme të veçuara, të cilat kanë role specifike dhe, për këtë arsye, formojnë një zinxhir të plotë të bizneseve të drogës: prodhim, transportim, shpërndarje dhe pastrim larash.³

Karteli ballkanik, pra, do të ishte një aleancë e organizatave kriminale nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Greqia, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Rumania dhe Serbia (ose, të paktën, nga disa prej këtyre vendeve) me një strukturë të ngurtë dhe një udhëheqës të shquar të sipërmarrjes kriminale dhe do të ishte në gjendje të prodhonte, transportonte dhe shpërndante drogë dhe të pastronte para. Nuk ekzistojnë prova që do të tregonin se ekziston një kartel i tillë i bashkuar. Nëse do të ekzistonte, do të ishte një fuqi e madhe në botën e krimit.

Nga të dhënat e disponueshme, del se panorama është disi më e nuancuar. Nga njëra anë, kriminelët nga ish-Jugosllavia vazhdojnë të veprojnë në njëfarë “sfere jugosllave” të kriminalitetit. Shpesh ata shfaqin karakteristikat e rrjeteve kriminale të përfshira në trafikimin e paligjshëm të komoditeteve, por nuk kanë kontroll territorial ose ndonjë tipar tjetër që është karakteristikë e grupeve të stilit mafioz. Këto rrjete zakonisht janë ndërkombëtare dhe bashkëpunojnë përtej kufijve dhe ndasive etnike. Në fakt, kriminelët në Ballkan shpesh duket se janë më efikas në bashkëpunimin ndërkufitar sesa agjencitë e zbatimit të ligjit.

Në Ballkan ka edhe organizata të stilit mafioz. Ka katër tipare, edhe pse jo ekskluzive, që përcaktojnë një grup mafioz: një emër i njohur, një udhëheqës ose udhëheqje (zakonisht hierarkike) e përcaktuar, kontrolli mbi një territor dhe anëtarësia e identifikueshme. Këto grupe (të cilat, shpesh, kanë për bazë një fis) mund të gjenden në pjesë të Shqipërisë ose në vatra të krimit të organizuar në pjesë të ndryshme të rajonit. Zakonisht ato përqendrohen në një qytet ose rajon të caktuar dhe, ndonëse mund të kenë bashkëpunëtor jashtë vendit, ato nuk kanë komunikim ndërkombëtar siç kanë rrjetet kriminale ose kartelet.

Nga ana tjetër, edhe pse mund të argumentohet se disa rrjete kriminale nga rajoni kanë disa karakteristika të karteleve, nuk ekziston asnjë kartel ballkanik homogjen dhe i unifikuar nën një komandë të centralizuar dhe me një strukturë kontrolli. Në fakt, ka rivalitet të dhunshëm midis disa grupeve dhe organizatave, madje edhe nga i njëjti vend, si klanet Kavaçi dhe Shkaljari në Mal të Zi ose klanet rivale në Shqipëri. Kriminelët nga Ballkani janë efikas edhe kur është fjala për bashkëpunimin me homologët e tyre jashtë rajonit, për shembull për t'u lidhur me furnizuesit e kokainës në Amerikën Latine ose me shpërndarësit në Evropën Perëndimore. Shkurt, pjesa më e madhe e grupeve kriminale në Ballkan ose nga Ballkani veprojnë më shumë si rrjete kriminale ose, në situata të izoluara, si grupe mafioze, dhe jo si kartelevë.

Krahas vlerësimit të vërtetësisë së këtij miti, pse është e rëndësishme të përcaktohet ekzistenca e një karteli ballkanik? Në bazë të përvojës së Amerikës Latine dhe Meksikës, ekzistenca e një karteli të tillë mund të

paraqesë rrezik serioz për sigurinë e vendeve në rajon, duke përfshirë kërcënimin e sovranitetit dhe monopolit të shtetit në përdorimin e forcës, çka do të shkaktonte nivele të larta dhune vdekjeprurëse dhe përmbysje dhe madje zëvendësim të disa funksioneve shtetërore, siç është ofrimi i sigurisë, krijimi i një ekonomie të qëndrueshme dhe kontrollimi i disa pikave kyçe të kalimit të kufirit.⁴ Kjo mund të kishte ndikim serioz edhe te siguria brenda vendeve ku ushtron aktivitetin karteli, për shembull në Amerikën Latine dhe Evropën Perëndimore, dhe tek ekuilibri i forcës (ose rivaliteteve të tregut) brenda ekonomive të paligjshme.

Origjinat e mitit

Nëse nuk ka kartel ballkanik për se, cili është burimi i mitit dhe pse vazhdon të ekzistojë? Në vitet 1980, të rinj, që vinin nga ajo që atëherë njihet me emrin Jugosllavi, ishin të përfshirë në botën e krimit në disa prej vendeve të Evropës Perëndimore. Disa punonin në "lagje me drita të kuqe" si roje klubi ose trafikues të qenieve njerëzore, ndërsa të tjerët i fitonin paratë nga marrëveshjet për mbrojtje, zhvatja dhe shitja e drogës ose si vrasës me pagesë.⁵ Në Holandë, për shembull, ata njiheshin me termin "*Yugomafia*" ndërsa në Suedi me termin "*Juggemaffian*".

Grupet kriminale nga Ballkani u bënë më të organizuara dhe më të dhunshme gjatë dhe pas luftërave në Jugosllavi, sidomos sepse kishin përvojë në luftë dhe qasje në armë. Të tjerët shijonin një shkallë mbrojtjeje nga ekonomitë kriminale, të zhvilluar me qëllim shmangien e sanksioneve. Edhe pse ata po krijojnë një faktor frike, ata ishin ende operatorë të papërfillshëm në skenën e krimit në Evropë: ata ishin aktiv sidomos në trafikimin e heroinës, armëve dhe njerëzve.

Miti i kartelit ballkanik lindi me grupin famëkeq kriminal që drejtohej nga Darko Shariçi, shtetas serb i Malit të Zi, i njohur si "mbreti i kokainës".⁶ Shariçi ra në sy të autoriteteve fillimisht në vitin 2000 kur policia serbe mori informata nga kolegët jashtë Serbisë lidhur me dyshime për pastrim parash.⁷ Në vitin 2007, policia italiane filloi procesin hetimor kundër Shariçit dhe klaneve të tjera kriminale serbe dhe malazeze që po merrnin nën kontroll tregun e kokainës nga mafia kalabreze "Ndrangeta".⁸ Në tetor të 2009-ës, në një jaht luksoz pranë Montevideos së Uruguait, në kuadër të operacionit "Luftëtari Ballkanik", u sekuestruan më shumë se dy tonë kokainë. U arrestuan dy vetë: një uruguaiian dhe një kroat.⁹ Operacioni "Luftëtari Ballkanik"

u përshkrua si operacion që parandaloi krijimin e një karteli ballkanik.¹⁰

Deri diku, përdorimi i shprehjes "kartel ballkanik" është gazetari e bujshme, e cila mbështetet në njohuri të kufizuara edhe rreth krimit të organizuar edhe rreth rajonit. Termi "kartel" përdoret si shkurtores për "grupet kriminale", ndërsa fjala "ballkanik" portretizohet si një monolit aktorësh kriminalë nga Evropa Lindore. Kur këta dy terma vihen bashkë, shprehja ka kuptimin e "një grupi kriminal gjithërajonal tepër të organizuar". Edhe pse nuk duket se ekziston asnjë kartel i tillë, ekziston një numër i mjaftueshëm aktorësh të cilët ose kërkojnë ta përjetësojnë mitin, ose, me anë të veprimtarive të tyre, shfaqin njëfarë shkalle bashkëpunimi ndërkombëtar.

Për shembull, në vitin 2015, autoritetet amerikane e klasifikuan Naser Kelmendin si "mbret kryesor droge" dhe udhëheqës të një familjeje kriminale në Ballkan, me një rrjet bashkëpunëtorësh nga i gjithë rajoni (sidomos në Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi dhe Serbi) dhe nga Evropa Perëndimore. Organizata kriminale e Kelmendit akuzohej për trafik droge dhe pastrim parash dhe madje u sanksionua edhe nga Shtëpia e Bardhë në kuadër të ligjit amerikan "Për mbretërit e drogës" të vitit 2012.¹¹ Në vitin 2018, ai u shpall fajtor për menaxhimin e operacioneve të narkotikëve, por më pas u lirua ndërkohë që pret për rigjykim.¹²

Në anën tjetër të botës, në vitin 2015, kriminelët e Ballkanit u damkosën në Australi si kërcënimi më i madh ndaj sigurisë së vendit. Lojtarët kryesorë njiheshin si gangsterët e lagjes "Kings Kros" dhe kontrollonin trafikimin e drogës drejt porteve të Australisë.¹³ Media e quajti udhëheqësin e pretenduar, Vaso Uliçin,¹⁴ si Pablo Eskobarin e ri. Uliçi pranoi në vitin 2019 në Mal të Zi se kishte organizuar një klan për trafikimin ndërkombëtar të drogës.¹⁵

Uliçi nuk ishte i vetmi të cilit iu vu ai titull. Edhe veprimtaria e Kelmend Balilit nga Shqipëria është portretizuar si "kartel ballkanik" dhe – për ta bërë mitin më të fuqishëm – Balilin e kanë quajtur edhe "Eskobar i Ballkanit".¹⁶ Në maj të 2016-ës, policia greke arrestoi 15 pjesëtarë të një rrjeti kriminal që kontrabandonte kanabis nga Shqipëria drejt Greqisë dhe Evropës, i cili financohej dhe drejtohej nga Balili, i cili në atë kohë ishte drejtor transportesh në Sarandë të Shqipërisë. Në fund ai u pushua nga puna dhe për të u lëshua një urdhër arresti. Ai ishte në gjendje të lirë deri në janar të 2019-ës, kur iu dorëzua policisë,¹⁷ njëllor siç kishte bërë Shariçi.¹⁸

Një tjetër shembull “mbreti droge i Ballkanit” ishte edhe Edin Gačanini, udhëheqës i kartelit “Tito dhe Dino”. Grupi i tij njihet si aktor i madh në kontrabandimin e kokainës nga Amerika e Jugut drejt Holandës.¹⁹ Shërbimet serbe të sigurisë besojnë se karteli “Tito dhe Dino” mori në kontroll biznesin e kokainës nga “Grupi Amerika” në vitin 2016, pas arrestimit të njërit prej pjesëtarëve të nivelit të lartë, Zoran Jakshiçit.²⁰

Fakti që ka disa lojtarë të mëdhenj në rajon ose nga rajoni tregon se ka një numër grupesh, por jo një kartel të unifikuar. Vetëm në Spanjë, përllogaritet se ka 100 grupe kriminale të organizuara nga Ballkani.²¹

Dhe prapëseprapë, edhe Europol përdor shprehjen “kartel ballkanik”, të cilin e përshkruan si “rrjet i krimit të organizuar”. Në kuadër të strategjisë së gjerë evropiane kundër të ashtu-quajturit “kartel ballkanik” janë realizuar disa operacione.²² Trafikimi i kokainës nga Kolumbia, Ekuadori dhe Panamaja drejt Evropës dhe Azisë është biznesi kryesor i kriminelëve të Ballkanit, por këta merren edhe me trafikim armësh. Pjesëtarët e kartelit ballkanik, sipas këtyre operacioneve, janë kryesisht kriminelë nga Serbia, Kroacia, Mali i Zi, Sllovenia dhe Bosnja dhe Hercegovina.


Miti përforcohet sa herë që rrëzohet një grup kriminal shumëkombësh. Për shembull, kohëve të fundit u arrestuan 48 persona në Slloveni, të cilët pretendohet se janë pjesë e një celule të një grupi kriminal malazet. Sipas akuzave penale të ngritura nga policia, 20 prej tyre ishin shtetas të Sllovenisë, 11 ishin nga Serbia, 9 nga

Bosnje dhe Hercegovina, 5 nga Kroacia, 2 nga Mali i Zi dhe 1 nga Maqedonia e Veriut. Këta shembuj tregojnë se ekzistojnë rrjete shumëtnike ose grupime nga Ballkani ose celula të lidhura me ndonjë klan të dhunshëm, por këto nuk provojnë ekzistencën e një karteli ballkanik.

Tentakula pa kokë

Nuk ka dyshim se organizatat kriminale nga Ballkani Perëndimor bashkëpunojnë. Disa kontrabandojnë sasi të mëdha kokaine nga Amerika e Jugut drejt Evropës, Amerikës së Veriut, Afrikës dhe Azisë. Një tjetër grup është edhe rrjeti i Panterës Rozë: një grup hajdutësh bizhuterish. Disa prej këtyre grupe janë shumëtnike dhe përbëhen nga pjesëtarë të cilët janë nga ish-Jugosllavia. Bashkëpunimi lehtësohet ngaqë pjesëtarët edhe kuptojnë gjuhët e njeri-tjetrit, por edhe kanë ngjashmëri kulturore. E njëjta logjikë vlen edhe për bashkëpunimin midis grupeve shqipfolëse. Disa grupe nga Ballkani Perëndimor bashkëpunojnë me organizata kriminale nga pjesa tjetër e Evropës Juglindore si Bullgaria, Kroacia, Greqia, Rumania dhe Sllovenia.

Pavarësisht kësaj, këto grupe ballkanike bashkëpunojnë edhe me grupe jashtë rajonit, që ndodhen, për shembull, në Evropën Lindore dhe Amerikën Latine. Në të vërtetë, disa kriminelë të Ballkanit duket se janë anëtarë kyç të grupeve që u ngjajnë karteleve, siç është rrjeti shumëkombësh “Kompanio Bello”, i cili u kap në shtator të 2020-ës.²³ Ky grup kryesisht shqipfolës, kishte organizuar dërgesa të konsiderueshme të kokainës nga Amerika Latine drejt Evropës Perëndimore.²⁴ Në tetor të 2021-shit, kur u arrestua drejtuesi i kartelit të fuqishëm



Referencat në lidhje me “kartelin ballkanik” në artikujt e medieve dhe në deklaratat e agjencive të zbatimit të ligjit.

kolumbian “Klani i Gjirit” (“Clan del Golfo”), u raportua se grupi i tij kishte lidhje me një numër rrjetesh të tjera kriminale, duke përfshirë ato nga Ballkani.²⁵ Prandaj, ngjashmëria etnike ose gjuha nuk duket se janë parakusht për bashkëpunim, por as nuk garantojnë bashkëpunimin. Sikurse vumë në dukje më lart, ndonjëherë ka konkurrencë të dhunshme edhe midis grupeve nga i njëjti rajon, madje edhe nga i njëjti vend.

Sikurse ka vënë në dukje organizata “InSight Crime”, “në botën e sotme të krimit, e cila është më fleksible se kurrë

më parë, askush prej këtyre grupeve nuk ka kapacitet të menaxhojë i vetëm rrugëtimin e kokainës nga prodhimi te shitja me pakicë. Përkundrazi, këto grupe formojnë dhe prishin rrjete dhe hyjnë e dalin nga aleancat me aktorë të ndryshëm nga i gjithë globi.”²⁶ Me pak fjalë, edhe pse është e qartë se ekziston një bashkëpunim ndëretnik midis grupeve kriminale nga Ballkani dhe që tentakulat e këtyre grupeve zgjaten në gjithë botën, këto tentakula as nuk janë të lidhura me një grup të vetëm dhe as nuk koordinohen nga i njëjti “tru”.

Shënime

- 1 Artikulli mbështetet në referencën: Saša Dorđević, *Balkanski kartel - razbijanje mita: Braća po narkoticima, Vreme*, 14 tetor 2021, <https://www.vreme.com/cms/view.php?id=1972245>.
- 2 Carlo DeVito, *The Encyclopedia of International Organized Crime [Enciklopedia e krimit të organizuar ndërkombëtar]*. Facts On File Crime Library, Checkmark Books, 2005.
- 3 Agjencia e Zbatimit të Ligjit për Drogën, Vlerësimi kombëtar për kërcënimin nga droga 2020, Departamenti Amerikan i Drejtësisë, mars 2021, www.dea.gov/sites/default/files/2021-02/DIR-008-21%202020%20National%20Drug%20Threat%20Assesment_WEB.pdf.
- 4 Robert J Bunker dhe John P Sullivan, Cartel evolution: Potentials and consequences [Evoluimi i karteleve: Potencialet dhe pasojat], *Transnational Organized Crime*, 1998, 4, 2, 55-74.
- 5 GI-TOC, Guns for gangs in Sweden: the Balkan connection [Armë për bandat në Suedi: Lidhja me Ballkanin], Buletini i Rreziqeve 4, janar-shkurt 2021, https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2021/01/Western-Balkans-RB-04_AL_web.pdf.
- 6 Bojana Jovanović dhe Stevan Dojčinović, Saric case: from international investigation to second judgement [Rasti i Sariçit: Nga hetimi ndërkombëtar te gjykimi i dytë], KRIK, 5 dhjetor 2018, www.krik.rs/en/saric-case-international-investigation-second-judgement.
- 7 *Utisak nedelje*, B92, 14 shkurt 2010, youtu.be/cLBCiaZwDBE.
- 8 Enco Manjini, *Italijanska veza Darka Šarića, Vreme*, 25 nëntor 2010, www.vreme.com/cms/view.php?id=963550.
- 9 Bojana Jovanović dhe Stevan Dojčinović, Saric Case: from International Investigation to Second Judgement [Rasti i Sariçit: Nga hetimi ndërkombëtar te gjykimi i dytë], KRIK, 5 dhjetor 2018, www.krik.rs/en/saric-case-international-investigation-second-judgement.
- 10 Djordje Odavic dhe Ratko Femic, Serbian Bureau victorious over ‘Balkan cartel’ [Byroja Serbe fitimtare ndaj “kartelit ballkanik”], *Novi Magazin*, 17 shkurt 2012, novimagazin.rs/english/11741-serbian-bureau-victorious-over-balkan-cartel.
- 11 Treasury Sanctions Network of Naser Kelmendi, U.S. Department of the Treasury [Rrjeti i sanksioneve të thesarit të Naser Kelmendit, Departamenti Amerikan i Thesarit], 24 mars 2015, www.treasury.gov/press-center/press-releases/Pages/j110007.aspx.
- 12 Labinot Leposhtica dhe Die Morina, Kosovo Court Jails Kelmendi For Drugs Running, *BalkanInsight* [Gjykata e Kosovës dënon me burg Kelmendin për trafikim droge], 1 shkurt 2018, balkaninsight.com/2018/02/01/naser-kelmendi-verdict-02-01-2018/ Naser Kelmendi released from prison [Lirohet nga burgu Naser Kelmendi], *Radio Televizija Crne Gore*, 3 gusht 2018, www.rtcg.me/english/balkans/210833/naser-kelmendi-released-from-prison.html.
- 13 Charles Miranda, Aussies running drug cartel [Australianët që drejtojnë kartel droge], *Townsville Bulletin*, 1 qershor 2015; Charles Miranda, Balkan link in drug web [Rrjeti i drogës lidhje me Ballkanin], *Gold Coast Bulletin*, 1 qershor 2015.
- 14 Dimitrije Jovičević, *Vaso Ulić, ‘crnogorski Escobar’?*, *Radio Slobodna Evropa*, 30 gusht 2017, www.slobodnaevropa.org/a/crna-goravaso-ulic/28705187.html.
- 15 Milica Vojinović, *Vasu Uliću dve godine zatvora za organizovanje međunarodnog šverca droge*, KRIK, 1 tetor 2019, www.krik.rs/vasu-ulicu-dve-godine-zatvora-za-organizovanje-medjunarodnog-sverca-droge/.
- 16 «Πολιτικοί προστατεύουν» το βαρόνο του καρτέλ των Βαλκανίων, *CNN Greece*, 11 mars 2016, www.cnn.gr/ellada/story/31784/politikoiprostatayoun-to-varono-toy-kartel-ton-valkanion.
- 17 Accused Albanian drug lord surrenders to police [Dorëzohet në polici mbreti shqiptar i akuzuar i drogës], *Reuters*, 15 janar 2019, www.reuters.com/article/us-albania-crime-surrender-idUSKCN1P924Q.
- 18 Marija Ristic, Dusica Tomovic dhe Bojana Barlovac, alleged Balkan drugs lord Darko Saric surrenders [Dorëzohet mbreti i akuzuar i drogës në Ballkan, Darko Sariç], *BalkanInsight*, 18 mars 2014, balkaninsight.com/2014/03/18/alleged-drug-boss-saric-arrested/.
- 19 Avdo Avdić, *Povezani sa italijanskom i južnoameričkom mafijom: Bosanski kartel Tito i Dino kontrolira narko tržište u Evropi*, *Žurnal*, 1 gusht 2019, zurnal.info/novost/22296/bosanski-kartel-tito-i-dino-kontrolira-narko-trziste-u-evropi.
- 20 Tamra Marković Subota, *Ko je kralj kokaina? Čovek koji je video Tita*, *Ekspres*, 1 janar 2020, www.ekspres.net/hronika/ko-je-kralj-kokaina-covek-koji-je-video-tita.
- 21 Patricia Ortega Dolz, The Balkan mafias wielding their power in Spain [Mafiet e Ballkanit që ushtrojnë pushtet në Spanjë], *El Pais*, 3 shtator 2020, english.elpais.com/spanish_news/2020-09-03/the-balkans-mafias-wielding-their-power-in-spain.html.
- 22 Europol, 100 kg of cocaine and 150kg of marijuana seized in major international operation dismantling Balkan cartel [Sekuestrohen 100 kg kokainë dhe 150 kg marihuanë në operacionin kryesor ndërkombëtar për shkatërrimin e kartelit ballkanik], 8 mars 2018, www.europol.europa.eu/newsroom/news/100kg-of-cocaine-and-150kg-of-marijuana-seized-in-major-international-operation-dismantling-balkan-cartel/; Europol, Coordinated hit against two big gun running operations in Europe [Operacioni i koordinuar kundër dy operacioneve të mëdha armësh në Evropë], 19 qershor 2018, www.europol.europa.eu/

- newsroom/news/coordinated-hit-against-two-big-gun-running-operations-in-europe; Europol, Balkan cartel trafficking cocaine around the globe in private planes busted [Asgjësohet karteli ballkanik që transportonte kokainë në gjithë botën me aeroplanë privatë], 23 korrik 2019, www.europol.europa.eu/newsroom/news/balkan-cartel-trafficking-cocaine-around-globe-in-private-planes-busted; Europol, Balkan cocaine cartel taken down in Montenegro [Bie karteli ballkanik i kokainës në Mal të Zi], 11 mars 2020, www.europol.europa.eu/newsroom/news/balkan-cocaine-cartel-taken-down-in-montenegro; Europol, Over 60 charged in crackdown on Balkan cartel behind cocaine pipeline to Europe [Mbi 60 persona të akuzuar pas operacionit policor kundër kartelit ballkanik që kontrollonte linjën e kokainës drejt Evropës], 27 shtator 2021, www.europol.europa.eu/newsroom/news/over-60-charged-in-crackdown-balkan-cartel-behind-cocaine-pipeline-to-europe.
- 23 Xhorxhina Bami, Interpol operation busts top ethnic Albanian drug smuggling ring [Operacioni i Interpolit shkatërron bandën kryesore shqiptare të kontrabandimit të drogës], *BalkanInsight*, 17 shtator 2020, balkaninsight.com/2020/09/17/interpol-operation-busts-top-ethnic-albanian-drug-smuggling-ring.
- 24 Eurojust, Joint investigation team leads to dismantling of one of Europe's most active Albanian-speaking networks trafficking cocaine into Europe [Ekipi hetimor i përbashkët çon në përmbysjen e një prej rrjeteve shqipfolëse më aktive në Evropë në fushën e trafikimit të kokainës drejt Evropës], 17 shtator 2020, www.eurojust.europa.eu/joint-investigation-team-leads-dismantling-one-europes-most-active-albanian-speaking-networks.
- 25 Hervé Bar, *Narcotrafic: le Clan del Golfo, meilleur ami des mafias [Klani i Gjirit, miku më i mirë i mafies]*, TV5 Monde, 3 nëntor 2021, <https://information.tv5monde.com/info/narcotrafic-le-clan-del-golfo-meilleur-ami-des-mafias-431023>.
- 26 Maria Fernanda Ramirez, Cocaine – The criminal steroid [Kokaina: Steroidi kriminal], *InSight Crime*, 9 February 2021, insightcrime.org/investigations/cocaine-criminal-steroid.

3. Përdorimi i kriptovalutave po fillon të marrë hov në rajon.

Ka shumë publicitet dhe debat lidhur me potencialin e kriptovalutës digjitale, ndërkohë që çmimet e bitkoinit ("Bitcoin") po arrijnë nivele rekord me mbi 55 000 euro për njësi. El Salvadori është vendi i parë në botë që e ka pranuar bitkoinin si monedhë zyrtare. Në Ballkanin Perëndimor, edhe pse niveli i përdorimit të kriptovalutave është relativisht i ulët, përdorimi i tyre në rajon është duke u rritur dalëngadalë. Kriptovalutat sjellin mundësi të reja, por krijojnë edhe rreziqe të reja, duke qenë se përdoren nga kriminelët për të lëvizur dhe pastruar paratë. Në këtë artikull shqyrtohet mënyra se si funksionojnë kriptovalutat dhe rreziku që ato paraqesin për rajonin, sidomos në lidhje me prurjet financiare të paligjshme.

Sistem financiar i hapur apo skemë "Ponzi"?

Kriptovalutat janë sisteme pagesash përmes internetit nga kompjuterë të barabartë ("peer-to-peer") të cilat kanë për bazë kriptografinë. Ato funksionojnë si "njësi digjitale shkëmbimi që nuk mbështetet nga tenderët ligjorë të emtuar nga qeveria".¹ Ato janë skedarë kompjuterikë të tenderuar si formë pagese për mallra dhe shërbime reale. Kriptovalutat funksionojnë duke përdorur bllokun-zinxhir ("block chain"), një libër digjital transaksionesh, i cili dublikohet dhe shpërndahet nëpër të gjithë rrjetin e përdoruesve të sistemit. Secili bllok në zinxhir përmban një numër transaksionesh dhe sa herë që kryhet një transaksion i ri, në librin e secilit pjesëmarrës shtohet një zë i atij transaksioni.

Ithtarët i konsiderojnë valutat virtuale si valë e së ardhmes për sistemet e pagesave. Ata e lavdërojnë shpejtësinë dhe thjeshtësinë e transaksioneve, çlirimim nga ndërmjetësit, siç janë bankat, dhe transparencën e bllokut-zinxhir, çka mund të ulë mundësitë e mashtrimit dhe modifikimeve të paautorizuara.²

Kritikët argumentojnë se kriptovalutat mbështeten më shumë në spekulim sesa në vlerën reale. Një analist në Maqedoninë e Veriut u shpreh kështu: "Kriptovalutat janë para imagjinare... Prapa tyre nuk ka asnjë ekonomi të kësobotshme". Ai paralajmëroi se vlera e kriptovalutave nuk i nënshtrohet rregullimit të autoriteteve monetare dhe se ato janë të cenueshme nga spekulimet financiare.³ Disa madje i kanë quajtur ato si "marifet" dhe "skemë "Ponzi"⁴

Një kritikë tjetër e përhapur që dëgjoet shpesh është se anonimiteti dhe rregullimi i dobët bëjnë të mundur që kriminelët t'i përdorin kriptovalutat për të lëvizur dhe ruajtur fonde të paligjshme dhe që personat që u shmangen detyrimeve tatimore të shmangin zbulimin, duke qëndruar aty ku agjencitë e zbatimit të ligjit dhe rregullatorët nuk arrijnë dot.

Kritikët vënë në dukje edhe ndikimin negativ të kriptovalutave⁵ në mjedis. Jo vetëm që nxjerrja e kriptovalutave ("cryptomining") konsumon shumë energji, por edhe pajisjet e nxjerrjes dhe qarqet kompjuterike që përdoren për nxjerrjen e bitkoinit zakonisht kanë jetë të shkurtër. Më tej, transaksionet në bitkoin kërkojnë një sasi shumë të madhe energjie dhe krijojnë mbetje elektronike.⁶

Përdorimi i kufizuar dhe rregullimi i ulët në Ballkanin Perëndimor

Përhapja e kriptovalutave në Ballkanin Perëndimor ka qenë relativisht e ngadaltë krahasuar me pjesët e tjera të Evropës. Një hartë-temperaturë e krijuar nga faqja "Coinmap", një sajt ueb ku shfaqen pikat ku pranohen pagesa në kriptovalutë në të gjithë botën, tregon se ka pak shkëmbime kriptovalutash ose bankomatë në Ballkanin Perëndimor, përveç në qytete të mëdha dhe përgjatë vijës bregdetare të Malit të Zi.⁷

Njëllor si paratë fizike, edhe kriptovalutat mund të përdoren nëpërmjet bankomatëve. Me rritjen e çmimit dhe popullaritetit të kriptovalutave, është duke u rritur ndjeshëm edhe numri i bankomatëve të kriptovalutave. Në të gjithë botën ka rreth 29 000 pajisje të tilla.⁸ Por fare pak prej tyre gjenden në Ballkanin Perëndimor. Sipas një burimi, në Serbi janë instaluar 5 bankomatë kriptovalutash (një në Nish dhe nga dy në Beograd dhe Novi Sad), katër në Kosovë (të gjithë në Prishtinë) dhe gjashtë në Bosnjë dhe Hercegovinë (nga tri në Banja Luka dhe Prijedor). Zyrtarisht, nuk ka asnjë bankomatë të tillë në Maqedoninë e Veriut, Shqipëri ose Mal të Zi.⁹ Edhe pse, për nga pamja e jashtme, bankomatët e bitkoinit ngjajnë me bankomatët e zakonshëm, ata nuk janë të lidhur me asnjë llogari bankare, por me një pikë këmbimi kriptovalutash. Klientët kanë mundësi të përdorin portofolin e tyre digjital për të blerë dhe shitur asetet virtuale.

Gjithashtu, njerëzit po paguajnë gjithmonë e më shumë për mallra dhe shërbime duke përdorur kriptovaluta, për shembull, në bare, kafene, restorante, hotele dhe spitale që e ofrojnë këtë opsion. Në Mal të Zi është e mundur të marrësh me qira edhe jahte duke paguar me kriptovalutë.¹⁰ Një biznes që pranon më shumë se 10 000 euro në para fizike nga një klient është i detyruar të plotësojë një formular për transaksionin valutor. Por këto rregulla nuk zbatohen edhe për kriptovalutat. Një biznes veturash të përdorura, i cili pranon 20 000 euro në bitcoin nga një klient, nuk është i detyruar të dorëzojë asnjë raport për transaksionin valutor. Këto të ardhura mund të mos taten nëse nuk raportohen në kthimin e taksave të pronarit të biznesit. Kjo nuk është situatë hipotetike: tri apartamente luksoze në Budva të Malit të Zi u shitën për 420 bitcoin (3,2 milionë dollarë amerikanë), ndërkohë një shoqatë lokale investimesh po nxit përdorimin e valutave digjitale në hotele dhe resorte në këtë destinacion të famshëm turistik.¹¹

Kjo teknologji ka hyrë në përdorim më shpejt sesa miratimi i ligjit për rregullimin e saj. Disa vende në rajon, si Kosova dhe Bosnja dhe Hercegovina, nuk kanë miratuar ligje për tregtimin e kriptovalutave ose rregullore për bankomatët e kriptovalutave. Por, megjithatë, këto pajisje nuk janë të paligjshme. Kjo krijon një zonë gri e cila është duke u shfrytëzuar.

Serbia dhe Shqipëria, nga ana tjetër, janë dy prej vendeve të para në botë që kanë krijuar një kuadër të qartë dhe siguri ligjore për investitorët dhe përdoruesit e aseteve digjitale.¹² Vendet e tjera në rajon kanë krijuar grupe pune të ngarkuar me detyrën e hartimit të kuadrove ligjorë.¹³

Në internet, larg librave të llogarive

Edhe pse kriptovaluta dhe nxjerrja e kriptovalutave janë të ligjshme, paratë digjitale janë një fushë e re për pastrimin e parave nga zyrtarë të korruptuar, biznesmenë ose grupe kriminale. Duke qenë se pjesa e konsiderueshme e veprimtarive joligjore në Ballkanin Perëndimor janë ndërkombëtare, grupet kriminale kanë nevojë për metoda të lëvizjes së parave të fituara nga trafikimi i drogës, armëve dhe njerëzve.

Më tej, shumë grupe kriminale nga Ballkani Perëndimor ushtrojnë veprimtarinë e tyre jashtë rajonit. Për këtë arsye, kriptovaluta u mundëson atyre t'i lëvizin paratë me shpejtësi dhe në mënyrë anonime përtej kufijve, duke përfshirë edhe dërgimin e parave drejt vatrës së tyre: Ballkanit Perëndimor. Aty ku rregullimi është i dobët, kriptovalutat, si asete lehtësisht të lëvizshme, shihen si mundësi e mirë për t'i futur në sistemin financiar të ardhurat nga veprimtaritë e paligjshme.



Bankomat bitkoini pranë një bankomati të zakonshëm në një pikë karburanti.

Foto: Chris Delmas/AFP nëpërmjet "Getty Images"

Njëlloj si procesi i pastrimit të parave fizike, edhe procesi i pastrimit të parave nëpërmjet kriptovalutave ka tri faza kryesore:

- Depozitimi: Fondet e paligjshme futen në sistemin financiar, për shembull, nëpërmjet këmbimit kriptovalutor ose bankomatëve.
- Transferimi në llogari të ndryshme: Në këtë fazë, kriminelët fshehin burimin e paligjshëm të fondeve, për shembull, duke e këmbyer një kriptovalutë me një tjetër ose duke marrë pjesë në ofertën fillestare të një monedhe.
- Integrimi: Paratë e paligjshme më pas futen në ekonominë e ligjshme si “të pastra”, për shembull, duke e kthyer kriptovalutën në para fizike nëpërmjet bankomatëve ose nëpërmjet ndërmjetësve të tregut të decentralizuar, të cilët përfitojnë një komision të majmë.

Në vendet që kanë rregullim ose zbatim të dobët të rregullave për “njohjen e klientit tënd”, vetë bankomatët mund të bëhen portal për pastrimin e parave. Për shembull, ata mund t’u lejojnë njerëzve të blejnë bitcoin nëpërmjet kartave të kreditit ose debitit ose, në disa raste, duke depozituar para fizike ose duke këmbyer kriptovalutat me para fizike. Në këmbim të një shpërblimi, pronarët e paskrupullt mund t’u lejojnë trafikantëve të drogës ose grupet e tjera kriminale të depozitojnë shuma të mëdha parash fizike në pajisjet e valutave virtuale dhe të fshehin burimin e fondeve.

Këmbimi kriptovalutor u mundëson klientëve të këmbejnë monedhat e reale me kripto-asete dhe anasjelltas.

Kjo krijon likuiditet në tregjet kriptovalutore. Kjo do të thotë edhe se këto këmbime janë portalet kyçe për pastrimin e parave që kanë të bëjnë me kripto-asetet. Kriminelët kërkojnë qëllimisht metoda këmbimi me rrezik të ulët, për të lëvizur fondet e tyre nga para letre (të emetuara nga qeveria) në kripto-asete dhe anasjelltas ose nga njëri kripto-aset tek një tjetër. Në një hapësirë e cila, deri më tani, nuk është e rregulluar sa duhet, kriminelët kërkojnë metoda këmbimi që janë të palicencuara dhe jo në pajtim me kërkesat ligjore, në lidhje me të cilat nuk është e nevojshme të zbatohen rregullat e “njohjes së klientit tënd” ose të “verifikimit të klientit”. Kriminelët përfitojnë edhe nga shërbimet e decentralizuara të këmbimit (siç është rrjeti “Ethereum”) për të dhënë hua ose për të marrë hua para, për të anashkaluar kontrollet e pajtueshmërisë me ligjet dhe për të përfituar nga fakti që këto sisteme nuk kanë

administrator qendror me mbikëqyrje aktive të llogarive të përdoruesve, regjistrave, identitetëve ose veprimtarive. Sajtet e kumarit në internet, të cilat pranojnë pagesa në kriptovalutë, u mundësojnë kriminelëve të blejnë çipsa me kripto-asete dhe t’i këmbejnë ato për para fizike pas disa transaksionesh.

Më tej, rrjetet e kompjuterëve të barabartë të kriptovalutave (“peer-to-peer”) u mundësojnë kriminelëve të lëvizin paratë, për shembull, drejt juridiksioneve ku rregulloret për parandalimin e pastrimit të parave janë më pak të rrepta. Gjithashtu, këto rrjete i ndihmojnë kriminelët që të kenë qasje në kurset e këmbimit ose te ndërmjetës që mund t’i kthejë kripto-asetet në para letre (të emetuara nga qeveria). Edhe teknologjia paraqet pengesa – si teknike, ashtu edhe ligjore – lidhur me sekuestrimin dhe rikuperimin e aseteve në kriptovalutë. Kjo është një fushë që paraqet vështirësi për avokatët dhe ata që merren me zbatimin e ligjit.

Platformat e kriptovalutave janë duke u përdorur edhe për mashtrime.¹⁴ Në një rast mashtrimi që kishte ndodhur në prill të vitit 2021, zyrtarët turq u bënë thirrje kolegëve të tyre shqiptarë për të ndihmuar në gjurmimin e një tregtari të arratisur i cili pretendohet se ishte larguar nga Tirana me 2 milionë dollarë amerikanë në asete digjitale, të cilat u përkisnin 700 000 personave.¹⁵ Krahas këtyre marifeteve brendapërbrenda sistemit, ekziston edhe rreziku i krimeve kundër protokollit të financave të decentralizuara (platformat e kriptovalutave) nga personat e jashtëm, nëpërmjet hakimit ose sulmeve me ransomuerë.

Minatorët digjitalë: Nxjerrja e kriptovalutave në Ballkanin Perëndimor

Edhe pse dalëngadalë kriptovalutat janë duke u bërë më të njohura dhe më të përhapura në Ballkanin Perëndimor, disa pjesë të rajonit, si veriu i Kosovës dhe disa komuna në Maqedoninë e Veriut, janë qendra aktive të nxjerrjes së kriptovalutave, domethënë përfundimisht të kriptovalutave duke zgjidhur ekuacione kriptografike nëpërmjet përdorimit të kompjuterëve, teknikë kjo që kërkon sasi të stërmëdha pajisjesh dhe energjie elektrike.

Duke përfituar nga statusi i tyre i paqartë juridik që prej shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, serbët në veri të Kosovës – në komunat e Leposaviqit, Mitrovicës, Zubin Potokut dhe Zveçanit – kanë më shumë se dy dekada që nuk paguajnë për energjinë elektrike. Papafingot, bodrumet, garazhet e madhe edhe

e gjithë shtëpia – për të cilat kërkohet qira e madhe – janë konvertuar për nxjerrjen e kriptovalutave. Në këtë proces, çdo vit konsumohen rreth 12 milionë euro energji elektrike pa pagesë. Është raportuar se nxjerrja e kriptovalutave në këtë zonë të vogël, ku popullsia përlloratet të jetë më e vogël se 50 000 banorë, konsumon 32 teravat-orë energji elektrike çdo vit, pothuaj aq sa e gjithë Danimarka.¹⁶

Nxjerrja e kriptovalutave po fillon të bëhet dukuri e zakonshme edhe në Maqedoninë e Veriut, për shembull, në Shkup, Tetovë dhe Aracinovë. Kompanitë e energjisë elektrike po vënë re se konsumimi i energjisë elektrike në disa pjesë të këtyre qyteteve është shumë më i lartë sesa konsumi normal.

Nxjerrja e kriptovalutave është e ligjshme dhe mund të jetë joshëse: fitimet zakonisht janë dy deri në tri herë më të larta sesa kostoja e investimit në qira, pajisjet e nxjerrjes dhe energjia elektrike.¹⁷ Ajo që është joligjore është bërja e lidhjeve të paligjshme me rrjetin e energjisë elektrike për të vjedhur energjinë që duhet për të nxjerrë kriptovaluta. Kjo është raportuar në qytetet e lartpërmendura të Maqedonisë së Veriut. Problemi është raportuar edhe në vende të tjera. Në gusht të vitit 2021,

vjedhja e energjisë elektrike u raportua në ish-fabrikën e mbushjes së ujit "Kruna", pranë Banja Lukës në Bosnjë dhe Hercegovinë: në vendngjarje u zbuluan 360 kompjuterë që përdorshin për nxjerrje kriptovalutash dhe u ngritën akuza për konsumim të paautorizuar të energjisë elektrike.¹⁸

Një prej efekteve anësore të nxjerrjes së kriptovalutave është ndërprerja e energjisë elektrike që shkaktohet nga mbingarkesa e rrjetit të shpërndarjes së energjisë. Sipas një përfaqësuesi të një kompanie lokale energjetike, "një shtëpi, nëse instalon kompjuterë për nxjerrjen e kriptovalutave... mund të konsumojë energji sa 20 ose 30 shtëpi, çka pengon seriozisht furnizimin me energji të të gjithë përdoruesve fqinjë në atë pikë furnizimi me energji".¹⁹ Në gjysmën e parë të vitit 2021, në Maqedoninë e Veriut u ngritën 120 akuza për vjedhje të energjisë elektrike. Në vitin 2020, u ngritën 250 akuza për përdorim të paautorizuar të energjisë elektrike.²⁰

Si përfundim, tregtia elektronike duket qartë se është valë e së ardhmes. Ndonëse përdorimi i kriptovalutave në Ballkanin Perëndimor aktualisht është i kufizuar dhe shkalla e përdorimit të tyre për të pastruar paratë dhe shmangur detyrimet tatimore mbetet e vështirë për t'u



Tel, i mbështjellë me një copë politeni, përdoret për të bërë lidhjet e paligjshme.

Foto: Tony karumba/AFP nëpërmjet "Getty Images"

matur, është e qartë se kriptovalutat po tërheqin shumë vëmendje. Sfida e vendeve të rajonit është të krijojnë një kuadër të fuqishëm rregullator dhe të sigurojnë që agjencitë ligj-zbatuese dhe rregullatorët të kenë mjete dhe kapacitete për të monitoruar kriptovalutat, për të

ulur rrezikun e pastrimit të parave dhe për t'i pajisur ekspertët e inteligjencies financiare me njohuri praktike me qëllim parandalimin e shfrytëzimit të kriptovalutave për krimin e organizuar dhe korrupsionin.

Shënime

- 1 Government Accountability Office, Virtual economies and currencies: Additional IRS guidance could reduce tax compliance risks (GAO-13-516), Report to the U.S. Senate Committee on Finance [Zyra për Llogaridhënie Qeveritare, Ekonomitë virtuale dhe valutat virtuale: Udhëzuesi shtesë i IRS-së mund të ulë rreziqet e pajtueshmërisë ligjore për detyrimet tatimore (GAO-13-516), Raport për Komitetin për Financa të Senatit të Shteteve të Bashkuara], 15 maj 2013, www.gao.gov/assets/gao-13-516.pdf.
- 2 Brian Armstrong, Cryptocurrencies' Time to Shine? [Koha për shkëlqimin e kriptovalutave?], Project Syndicate, 8 prill 2020, www.project-syndicate.org/commentary/rise-of-cryptocurrencies-after-covid19-pandemic-by-brian-armstrong-2-2020-04.
- 3 Kripto-valuti: Od zelba za brza zaraboptuvacka do kolaps, NOVA TV, 20 shkurt 2018, novatv.mk/kripto-valuti-od-zhelba-za-brza-zarabotuvachka-do-kolaps/.
- 4 Kevin Stankiewicz, 'Black Swan' author calls bitcoin a 'gimmick' and a 'game,' says it resembles a Ponzi scheme [Kevin Stankieviçi, autor i "Mjellmës së Zezë", e quan bitkoinin "truk" dhe "lojë", duke shtuar se ai i ngjan skemës "Ponzi"], CNBC, 23 prill 2021, www.cnbc.com/2021/04/23/bitcoin-a-gimmick-and-resembles-a-ponzi-scheme-black-swan-author-.html.
- 5 Bojan Stojkovski, Ditching dinars: Will the Balkans take to Cryptocurrency?, BalkanInsight [Të heqësh qafe dinarët: A do të përqafojë Ballkani kriptovalutat?], 17 shtator 2020, balkaninsight.com/2020/09/17/ditching-dinars-will-the-balkans-take-to-cryptocurrency.
- 6 Kriptovalutat dhe dëmtimi nga mbetjet elektronike, Vrabotuvanje.com, 20 shtator 2021, www.vrabotuvanje.com.mk/Sovet/12417/Kriptovaluti-i-shtetite-od-elektronskiot-otpad/7.
- 7 Shihni: <https://coinmap.org/view/#/world/47.19717795/17.24853516/6>.
- 8 Për hartën e bankomatëve të bitkoinit, vizitoni faqen: coinatmradar.com.
- 9 Klasifikimi i bankomatëve të bitkoinit sipas vendeve jepet në këtë faqe interneti: <https://coinatmradar.com/countries>.
- 10 Business Wire, Royal yacht brokers to accept cryptocurrencies and gold as payment for luxury yacht rental services [Ndërmjetësit e jahteve mbretërore do të pranojnë kriptovaluta dhe ar si pagesa për shërbimet e jahteve luksoze me qira], 28 tetor 2017, <https://www.businesswire.com/news/home/20171028005014/en/Royal-Yacht-Brokers-Accept-Cryptocurrencies-Gold-Payment>.
- 11 Jamie Redman, Three luxury apartments sold for 420 BTC in the coastal region of Montenegro [Shiten për 420 bitkoin tri apartamente luksoze në rajonin bregdetar të Malit të Zi], Bitcoin.com, 8 qershor 2018, news.bitcoin.com/three-luxury-apartments-sold-for-420-btc-in-the-coastal-region-of-montenegro.
- 12 Ligji "Për asetet digjitale", Republika e Serbisë, Gazeta Zyrtare nr. 153/2020, www.nbs.rs/export/sites/NBS_site/documents-eng/



Pajisje për nxjerrjen e bitkoinit, e vënë në shitje në internet në Maqedoninë e Veriut.

Foto: Pazar3

- propisi/zakoni/digitalna_imovina_e.pdf; Ligji nr. 66/2020 "Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistruar të shpërndarë", Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, <http://www.parlament.al/Files/Akte/20200603130931ligj%20nr.%2066,%20dt.%2021.5.2020.pdf>.
- 13 Intervista me përfaqësues të Zyrares së Inteligjencës Financiare të Bosnjës dhe Hercegovinës, Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe Malit të Zi, 1 tetor 2021.
 - 14 Two charged, one wanted on cryptocurrency fraud in Albania [Dy të akuzuar, një i shpallur në kërkim për mashtrim me kriptovalutat në Shqipëri], Exit News, 26 qershor 2021, exit.al/en/2021/06/26/two-charged-one-wanted-on-cryptocurrency-fraud-in-albania.
 - 15 Hamdi Firat Buyuk, Turkey asks Albania to detain fugitive cryptocurrency fraud suspect [Hamdi Fërat Byjku, Turqia i kërkon Shqipërisë të ndalë të dyshuarin e arratisur për mashtrim me kriptovaluta], BalkanInsight, 23 prill 2021, balkaninsight.com/2021/04/23/turkey-asks-albania-to-detain-fugitive-cryptocurrency-fraud-suspect.
 - 16 Arbësa Hoxha-Dobrunaj, Smuggling, cryptocurrencies and illegal mining in northern Kosovo [Kontrabandimi, kriptovalutat dhe nxjerrja joligjore e kriptovalutave në veriun e Kosovës], Robert Lansing Institute for Global Threats and Democracies Studies, 19 maj 2021, lansinginstitute.org/2021/05/19/smuggling-cryptocurrencies-and-illegal-mining-in-northern-kosovo.
 - 17 Adelina Ahmeti dhe Kreshnik Gashi, Crypto mining machines confiscated by Kosovo authorities in Pristina [Autoritetet kosovare në Prishtinë konfiskojnë pajisjet për nxjerrjen e kriptovalutave], BalkanInsight, 12 maj 2021, balkaninsight.com/2021/05/12/in-north-kosovo-mining-for-bitcoin-on-free-electricity.
 - 18 Dejan Tovilović, U Damjanovićevoj „Kruni“ krađu struju za rudarenje kriptovaluta, Capital, 14 tetor 2021, www.capital.ba/u-damjanovicevoj-kruni-krađu-struju-za-rudarenje-kriptovaluta.
 - 19 Tose Ognjanov, Некои со легални влогови, а некои и со крадење струја: Сè повеќе македонски граѓани „копаат“ криптовалути, VOA, 10 qershor 2021, mk.voanews.com/a/voa-crypto-currency-mkd-article-toshe-ognjanov/5923962.html.
 - 20 Aleksandra Filipovska, Лесна заработувачка со копање на биткоиини- однесе во полициска станица жител на Ѓорче Петров, Telma, 17 korrik 2021, telma.com.mk/2021/07/17/лесна-заработувачка-со-копање-на-битк.

4. Ndërtimi i urave midis shoqërisë civile dhe qeverisë në Maqedoninë e Veriut.

Në datat 22 dhe 23 shtator 2021, Observatori i Ekonomive të Paligjshme në Evropën Juglindore i GI-TOC-së ftoi përfaqësues të shoqërisë civile për të marrë pjesë në një sërë konsultimesh në Shkup. Takimet ofruan mundësinë për të fuqizuar qëndrueshmërinë dhe rrjetet e OSHC-ve që trajtojnë krimin e organizuar dhe korrupsionin në Maqedoninë e Veriut, për të bërë përpjekje për ndërtimin e urave midis shoqërisë civile dhe qeverisë në lidhje me këto çështje, dhe për t'i bërë një ekspozitë punës së GI-TOC-së në kryeqytetin e Maqedonisë. Ky ishte takimi i parë i një vargu "dialogësh rreth qëndrueshmërisë" që do të zhvillohen në kryeqytetet e të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor midis shtatorit dhe dhjetorit të 2021-shit.

Për këta dialogë rreth qëndrueshmërisë ndiqet një proces i ngjashëm që filloi në vitin 2020, i cili bëri tok një grup të shumëllojshëm aktorësh të shoqërisë civile nga i gjithë rajoni me qëllim shkëmbimin e përvojave dhe ekspertizës dhe fuqizimin e rrjeteve kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Nga seria e evenimenteve komunitare dolën të dhëna të detajuara rreth një shumëllojshmërie të madhe aktorësh të shoqërisë civile dhe rreth nismave të ndërmarra në gjithë rajonin. Rezultatet e procesit u publikuan në mars të vitit 2021 në raportin me titull "Së bashku jemi më të fortë: Forcimi i qëndrueshmërisë së shoqërisë civile në vendet e Ballkanit Perëndimor".

Takimi në Shkup nisi vitin e dytë të dialogëve dhe përfshiu aktorë të shoqërisë civile në Maqedoninë e

Veriut, sidomos ata që janë përfitues të granteve të Fondit të Qëndrueshmërisë të GI-TOC-së, si dhe OSHC-të që janë pjesë e Rrjetit rajonal të Ekspertëve të GI-TOC-së. Në këtë rreth të ngushtë, pjesëmarrësit bashkëdanë pikëpamjet e tyre lidhur me sfidat me të cilat përballen OSHC-të gjatë punës së tyre në trajtimin e krimit të organizuar dhe identifikuan nevojat për ngritjen e kapaciteteve dhe fuqizimin e rrjeteve. Një pjesëmarrës u shpreh: "Këtë problem nuk e luftojmë dot të vetëm".

Në sfidat e identifikuara bënin pjesë: efekti shkatërrues i korrupsionit (për shembull, në politikë dhe në sektorin e kujdesit shëndetësor), instrumentalizimi i fushatave kundër korrupsionit për qëllime të agjendave politike, kapja e qeverisë (duke përfshirë edhe atë lokale), mungesa e qasjes në informacione zyrtare dhe ndjekja e dobët penale e rasteve. Kishte edhe zhgënjime që ndryshimi i qeverisë në vitin 2017 nuk kishte sjellë ndryshime të konsiderueshme, pavarësisht përfshirjes së ish-anëtarëve të shoqërisë civile në pushtetin ekzekutiv.

Më tej, u vu në dukje se duhet të ketë më shumë mbështetje për kërkime shkencore lidhur me krimin e organizuar, rritje të mbështetjes për OSHC-të jashtë kryeqytetit, përqendrim më të fuqishëm tek arsimit (sidomos për të kundërvepruar ndaj "kulturës së korrupsionit"), më shumë vëmendje ndaj problematikave që paraqesin shqetësim për të rinjtë dhe më shumë hulumtime shkencore lidhur me efektet pozitive dhe



Pamje e Shkupit, Maqedonia e Veriut.

Foto: Zefart | Dreamstime

negative të digjitalizimit, si dhe bashkëpunim më të madh midis OSHC-ve, medias dhe akademisë në ekspozimin dhe adresimin e krimit mjedisor. Gjithashtu, pjesëmarrësit diskutuan rreth mënyrave për vënien në dukje të dëmeve të krimit të organizuar dhe të korrupsionit dhe mënyrave për të zhvilluar narrativa për ndryshim dhe për promovimin e rol-modeleve pozitive për frymëzimin e njerëzve.

Një problem i përsëritshëm në Maqedoninë e Veriut dhe në gjithë rajonin është mungesa e dialogut domethënës ose angazhimit midis OSHC-ve dhe qeverisë. OSHC-të shpesh konsiderohen nga qeveria si faktor bezdisës e madje edhe antiqeveritar. Ekstremi tjetër është që OJQ të caktuara janë kooptuar nga qeveria, marrin fonde dhe mbështesin pozicionet që merr qeveria, çka i bën ato *de facto* OJQ të drejtuara nga qeveria.

Për ta trajtuar këtë problematikë, GI-TOC-ja, së bashku me institutin kërkimor me seli në Shkup, "Eurothink – Qendra për Strategji Evropiane", organizuan së bashku një takim midis OSHC-ve dhe zyrtarëve qeveritarë në lidhje me "ndërtimin e urave midis shoqërisë civile dhe qeverisë" për të diskutuar mekanizmat ekzistues të bashkëpunimit midis shoqërisë civile dhe qeverisë dhe për fushat e mundshme që kanë nevojë për përmirësim. Pjesëmarrësit nga shoqëria civile dhe qeveria, ku bënin pjesë përfaqësues nga Ministria e Punëve të Brendshme, Parlamenti, Komiteti Kombëtar për Ekstremizmin e Dhunshëm dhe Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, ranë dakord se, kur është fjala për parandalimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe luftën ndaj tyre, shoqëria civile dhe qeveria duhet të jenë në të njëjtin krah.

Kjo seancë ishte një mundësi edhe për të shkëmbyer haptas pikëpamjet dhe idetë lidhur me mënyrën se si duhet përmirësuar bashkëpunimi, sidomos në lidhje me çështjen e migrimit. Disa pjesëmarrës nga shoqëria civile bënë thirrje për një rol më të madh të OJQ-ve në vlerësimin e performancës së qeverisë në trajtimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar, për shembull, në kuadrin e anëtarësimit në BE. U vu në dukje edhe se OJQ-të duhet të konsultohen më gjerësisht gjatë procesit të hartimit të legjislacionit përkatës dhe të strategjive kombëtare dhe se duhet t'u jepen mundësi të barabarta për të ndërvepruar me zyrtarë qeveritarë në organet konsultative.

U diskutuan edhe mënyrat për të ruajtur qëndrueshmërinë e projekteve dhe vazhdimësinë e angazhimit midis OSHC-ve dhe qeverisë, për shembull, nëpërmjet krijimit të një sekretariati shtetëror për sektorin e OJQ-ve. Disa pjesëmarrës shprehën mendimin se është e rëndësishme që sektori privat dhe drejtuesit fetarë të angazhohen në mënyrë më aktive në drejtim të forcimit të integritetit dhe luftimit të korrupsionit.

Gjatë vizitës së tij, ekipi i GI-TOC-së u takua me Ministrin e Punëve të Brendshme, Oliver Spasovski. Takimi ofroi mundësinë për të përshkruar punën dhe përpjekjet e GI-TOC-së në drejtim të përmirësimit të bashkëpunimit midis shoqërisë civile dhe qeverisë në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, si dhe për të folur për rëndësinë e nxitjes së bashkëpunimit më efikas rajonal në luftën kundër krimit të organizuar ndërkombëtar.

Konsultimet treguan se urat midis qeverisë dhe shoqërisë civile nuk mund të ngrihen brenda natës. Megjithatë, themelet mund të hidhen përmes dialogut.

5. “Shkapja” e shtetit: Intervistë me OJQ-në Maqedonase “Eurothink”.

Në pjesën më të fundit të serisë së rregullt ku profilizohet puna e organizatave të shoqërisë civile në Ballkanin Perëndimor që janë duke punuar për të fuqizuar qëndrueshmërinë ndaj krimit të organizuar, ne flasim me Dimitar Nikolovskin dhe Aleksandar Stojanovskin të organizatës “Eurothink – Qendra për Strategji Evropiane” me seli në Shkup të Maqedonisë së Veriut.

Cili është historiku dhe kompetenca e organizatës “Eurothink”?

Organizata “Eurothink” u themelua në vitin 2002 me emrin “Qendra Maqedonase për Trajnime Evropiane”. Në fillim, fokusi ishte te trajnimet për ata që punojnë në administratën publike, shoqërinë civile dhe media, në lidhje me temat që kanë të bëjnë me anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Në vitin 2007, organizata ndërroi emrin dhe u quajt “Eurothink – Qendra për Strategji Evropiane”. Ky ndryshim ishte pasqyrim i ndryshimit të fokusit nga trajnimet te një OSHC e orientuar më shumë nga kërkimi shkencor, e përkushtuar ndaj kryerjes dhe

bashkëndarjes së kërkimeve rreth politikave dhe ndaj aktiviteteve të mbështetura në dëshmi e prova.

Kur dhe pse e ndryshoi organizata “Eurothink” fokusin nga përqendrimi te BE-ja te puna lidhur me krimin e organizuar dhe korrupsionin?

BE-ja vazhdon të jetë fokusi kryesor i punës sonë, por në vitin 2016, ne zgjeruam fushëveprimin tonë për të adresuar disa prej çështjeve kryesore me të cilat përballet vendi ynë, si p.sh. ekstremizmi i dhunshëm, emigracioni, korrupsioni, krimi i organizuar dhe çështjet mjedisore. Pas ngjarjeve dramatike në lidhje me rrëzimin e qeverisë së Nikola Gruevskit, ne menduam se ekzistonte nevoja të përqendroheshim më shumë te çështjet që kanë të bëjnë me kapitullin 24 të *acquis*-it të BE-së lidhur me drejtësinë, lirinë dhe sigurinë. OJQ-të që kishin për fokus korrupsionin ishin të pakta në numër, por pothuaj asnjëra prej tyre nuk kishte për fokus problematikat e krimit të organizuar, në lidhje me proceset e kapitullit 24.



Dimitar Nikolovski dhe Aleksandar Stojanovski të organizatës “Eurothink – Qendra për Strategji Evropiane”, Shkup.

Si do ta vlerësonit ju përparimin e Maqedonisë së Veriut, sidomos në lidhje me kapitullin 24?

Qeveria aktuale, sigurisht, po bën një punë më të mirë sesa qeveria e mëparshme: ia vlen të përmend këtu që Komisioni Evropian një herë e përshkroi Maqedoninë e Veriut, nën regjimin e Gruevskit, si "shtet të kapur". Në fakt, ecuria ka qenë aq e mirë sa që arritëm të merrim ftesë për hapjen e negociatave me BE-në rreth anëtarësimit, përpara se kjo të bllokohej nga Bullgaria. Por ka vend për përmirësim, për shembull, në lidhje me uljen e nivelit të politizimit të policisë (duke përfshirë edhe procesin e shqyrtimit të hollësishëm (vetingut)), përmirësimin e hetimeve financiare dhe konfiskimin dhe rikuperimin e asetëve, përmirësimin e menaxhimit të kufijve dhe krijimin e procedurave më efektive të kërkimit të azilit.

Si mund të ndihmojnë organizatat e shoqërisë civile si "Eurothink"-u në zbatimin e kapitullit 24?

Ne mund të luajmë rolin e mbrojtësve të demokracisë, duke monitoruar zbatimin. Në Maqedoninë e Veriut, kemi krijuar një rrjet OJQ-sh të interesuara të quajtura "Rrjeti 24" ("Network 24") posaçërisht për të luajtur këtë rol. Megjithatë, shoqëria civile – sikurse ne – mund të ndihmojë edhe në mënyra të tjera, nëpërmjet bërjes së analizave dhe dhënies së rekomandimeve, realizimit të sondazheve për matjen e opinionit publik rreth çështjeve me rëndësi, ofrimin e informacioneve lidhur me nevojat, interesat dhe pikëpamjet e qytetarëve, rritjen e vetëdijesimit dhe ofrimin e mbështetjes profesionale. Ne kemi publikuar edhe udhëzues specifikë për përfshirjen e OSHC-ve në kapitullin 24.¹

Ju publikoni një "Eurometer" periodik, i cili mat qëndrimet e publikut ndaj BE-së. Si e vlerësoni ju opinionin publik aktual në Maqedoninë e Veriut në lidhje me anëtarësimin në BE, duke marrë parasysh sinjalin e dobët nga samiti i fundit midis BE-së dhe Ballkanit Perëndimor në Bërdo dhe bllokimin e vazhdueshëm nga Bullgaria të ambicieve të Maqedonisë së Veriut për t'u anëtarësuar në BE?

"Eurometer"-in e kemi publikuar që prej vitit 2014. Duke qenë se bëjmë të njëjtat pyetje çdo herë, është interesante të gjurmosh se si evoluojnë opinionet.² Që prej vitit 2014, mbështetja e popullsisë për BE-në ka qenë e lartë (rreth 70%), por kohët e fundit kemi vënë re një rënie të saj. Njerëzit po fillojnë të humbin shpresën dhe po kërkojnë për alternativa ndaj anëtarësimit në BE. Për fat të mirë, opsionet autoritare nuk janë ende aq të përhapura.

Në të shkuarën, Maqedonia e Veriut është përshkruar si "shtet i kapur". Si do ta vlerësonit ju mbikëqyrjen demokratike të sigurisë dhe shërbimeve të inteligjencës?

Skandali i përgjimeve që ndodhi në vitin 2015 vërtet e tronditi vendin. Me sa duket, bisedat private të më shumë se 20 000 personave ishin përgjuar në mënyrë të paligjshme, nën drejtimin e zyrtarëve të lartë të qeverisë dhe të agjencisë së inteligjencës. Kjo demonstroi tiparet e disa prej regjimeve më jodemokratike. Sfidat tani është ta "shkapim" shtetin. Janë ndërmarrë reforma të rëndësishme për të përforcuar mbikëqyrjen parlamentare dhe civile të sektorit të sigurisë, për ta bërë aparatit të inteligjencës më llogaridhënës dhe më transparent. Megjithatë, ende ekziston nevoja për përparim, sidomos në lidhje me gjyqësorin dhe prokurorinë, të cilat vazhdojnë të jenë hallkat më të dobëta në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit në këtë vend. Kjo është një problematikë që duhet të jetë në fokus të BE-së dhe të të gjithë atyre që përpiqen të shërojnë plagët e shkaktuara nga krimi i organizuar dhe korrupsioni në Maqedoninë e Veriut.

"Eurothink"-u është përqendruar edhe te krimi mjedisor në Maqedoninë e Veriut. Kësaj teme i kushtohet relativisht pak vëmendje në rajon. Pse vendosët të përqendrohni te prerja dhe transportimi i paligjshëm i drurëve dhe çfarë zbuluat gjatë kërkimeve tuaja?

Gjatë viteve të fundit, çështjet mjedisore janë bërë ndër prioritetet kryesore në agjendat politike në shumë vende, por jo në Maqedoninë e Veriut. Ka të ngjarë që kjo që të ketë ndodhur për shkak të të gjitha problemeve të tjera që kanë ndodhur në lidhje me skandalet politike, marrëdhëniet dypalëshe dhe anëtarësimin në BE. Ne donim të përqendroheshim te ndikimi i çështjeve mjedisore sepse menduam se kjo fushë ishte lënë pas dore. Sa më shumë që e shqyrtonim situatën, aq më shumë e kuptonim se politikat dhe menaxhimi i keq i burimeve natyrore po çonin në ndotjen e ajrit dhe në probleme shëndetësore.

Ka një numër faktorësh që po kontribuojnë në problemet mjedisore në këtë vend, që kanë të bëjnë, për shembull, me menaxhimin e mbetjeve, politikën për energjetikën, planifikimin urban dhe menaxhimin e trafikut. Rezultati është që Shkupi ka disa prej niveleve më të larta të ndotjes në Evropë, madje edhe pse nuk ka shumë industri të rëndë. Një prej gjërave që konstatuam ishte se numri i njerëzve që i ngrohin shtëpitë me dru është

shumë më i lartë sesa numri që raportohet zyrtarisht. Disa lloje pemësh që priten në Maqedoninë e Veriut po shiten si dru ekzotik. Të dy këto lloje drurësh po priten dhe transportohen në mënyrë të paligjshme nga pyjet e Maqedonisë. Nga kërkimi ynë, doli se gjysma e të gjithë lëndës drusore që nevojitet për të ngrohur shtëpitë në Maqedoninë e Veriut merret nga burimi në mënyrë të paligjshme. Sipas përlogaritjeve tona, ky është treg i paligjshëm me vlerë 60 milionë euro në vit. Nëse vazhdohet me këtë ritëm, do të ketë pasoja të rënda për vendin tonë brenda vetëm 10 deri në 15 vjet.

Pas publikimit të raportit tuaj, a pati ndonjë monitorim nga ana e qeverisë?

Ndoshta ishte rastësi, por pak kohë pasi u publikua raporti, policisë pyjore iu dhanë uniforma të reja, pajime më të mira dhe paga më të larta.³ Krahas kësaj, u themelua një organ ndërministror për të trajtuar çështjen e prerjes dhe transportimit të paligjshëm të drurëve. Pavarësisht kësaj, zjarret shkatërruese që rrënuan pyjet në Maqedoninë e Veriut këtë verë lënë të kuptohet se mund të ketë individë që i vënë zjarret në mënyrë të qëllimshme për të përfituar leje për të pastruar pemët e djegura. Këto raste dhe vazhdimi i prerjes dhe transportimit të paligjshëm të drurëve tregojnë se mbetet ende shumë për t'u bërë në drejtim të parandalimit dhe luftimit të shkatërrimit të pyjeve tona.

Shënime

- 1 Udhëzuesit mund t'i gjeni në faqen: eurothink.mk/2021/03/23/5066.
- 2 Për krahasimin gjatësor, vizitoni faqen: eurothink.mk/2021/05/04/duplicated-2014-2021-5117.
- 3 Raportin mund ta gjeni në linkun: eurothink.mk/wp-content/uploads/2021/02/CIP-FINAL-Izvestaj-Drvokradci-AN.pdf.
- 4 Për më shumë hollësi, shihni: Saska Cvetkovska et al., 'Europe's waste dump': How dangerously polluting oil ended up heating

A keni shqyrtuar lloje të tjera të krimeve mjedisore?

Ka shenja për importim të paligjshëm të mbetjeve drejt Maqedonisë së Veriut.⁴ Ky është biznes i madh. Ka një problem me mungesën e rregullimit në landfillet dhe ekziston rreziku i shfrytëzimit mineral. Ka shenja që tregojnë se procesi i kalimit në ekonomi të gjelbër është duke u shfrytëzuar nga grupe të fuqishme lobimi me lidhje të mundshme me elitën politike, afariste dhe kriminale.

Si punoni me qeverinë për të sjellë ndryshime?

Mund t'ju duket për të qeshur, por aty ku është e mundur, ne përpiqemi të nënshkruajmë memorandumet mirëkuptimi me homologët tanë në qeveri. Kjo praktikë mund të hapë dyert kur kemi probleme në nivelin lokal. Gjithashtu, përpiqemi të jemi këmbëngulës, pra që t'i mbajnë problematikat tona në agjendë, edhe nëse ato nuk bëjnë pjesë në prioritetet kryesore aktuale të politikës. Në përgjithësi, ne përpiqemi të kemi kontakte të mira personale me homologët tanë dhe të krijojmë besim. Ndonjëherë, të punosh me qeverinë është si të vallëzosh: duhet të bësh lëvizje të ndryshme sipas rastit dhe kjo varet edhe nga partneri. Ne përpiqemi të ndjekim një qasje konstruktive. Në fund të fundit, kur është fjala për çështjet që ne mbulojmë, qeveria dhe shoqëria civile duhet të jenë në të njëjtën anë.


North Macedonia's hospitals [Vendshkarkimi i mbetjeve të Evropës: Si përfundoi vaji ndotës i rrezikshëm si lëndë ngrohjeje në spitalet e Maqedonisë së Veriut], Organized Crime and Corruption Reporting Project, 21 maj 2021, www.occrp.org/en/investigations/europes-waste-dump-how-dangerously-polluting-oil-ended-up-heating-north-macedonias-hospitals.

Pasqyrë e shkurtër e publikimeve

Në këtë pjesë, do të paraqesim një pasqyrë të përgjithshme të publikimeve të fundit rreth krimit të organizuar në rajon. Këto publikime mbulojnë një gamë të gjerë çështjesh dhe në to bëjnë pjesë edhe publikimet e reja dhe të ardhshme të GI-TOC-së.

<p>Nadia El-Shaarawi dhe Maple Razsa, Movements upon movements: Refugee and activist struggles to open the Balkan route to Europe [Lëvizje pas lëvizjesh: Përpjekjet e refugjatëve dhe aktivistëve për të hapur rrugën e Ballkanit drejt Evropës], <i>History and Anthropology</i>, 30, 1, 91–112.</p>	<p>Në vitet 2015–2016, 1,2 milionë refugjatë kërkuan siguri në Evropë duke kaluar përmes rrugës ballkanike. Ky studim shpjegon mënyrën se si ndodhi kjo lëvizje e paprecedentë e njerëzve nga pikëpamja etnografike.</p>
<p>Andi Hoxhaj dhe Fabian Zhilla, The impact of COVID-19 measures on the rule of law in the Western Balkans and the increase of authoritarianism [Ndikimi i masave "KOVID-19" në shtetin e së drejtës në Ballkanin Perëndimor dhe rritja e autoritarizmit], <i>European Journal of Comparative Law and Governance</i>, 8, 4, 271–303.</p>	<p>Në këtë artikull, jepet një analizë krahasuese e masave ligjore "KOVID-19" dhe e modeleve të qeverisjes të miratuara në Ballkanin Perëndimor (Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoni të Veriut dhe Serbi). Gjithashtu, në këtë artikull shqyrtohet edhe ndikimi në shtetin e së drejtës dhe aftësinë e parlamenteve dhe shoqërisë civile për të shqyrtuar imtësisht vendimet e qeverisë.</p>
<p>Marko Kmezić dhe Dejan Atanasijević, How organized is organized crime and drug trafficking in Serbia [Sa i organizuar është krimi i organizuar dhe trafikimi i drogës në Serbi], <i>Kriminalističke teme - Časopis za kriminalistiku, kriminologiju i sigurnosne studij</i>, 19, 6, 1–14.</p>	<p>Prodhimi dhe trafikimi i drogës në Serbi është forma mbizotëruese dhe më fitimprurëse e krimit të organizuar. Në këtë studim shqyrtohen marrëdhëniet politike, ekonomike dhe sociale të personave të përfshirë në trafikimin e drogës në Serbi.</p>
<p>Sandro Knezović, Vlatko Cvrtila dhe Zrinka Vučinović, Croatia's police and security community building in the Western Balkans [Policia e Kroacisë dhe ndërtimi i komunitetit të sigurisë në Ballkanin Perëndimor], <i>Eastern Journal of European Studies</i>, 8, 2, 167–184.</p>	<p>Në këtë artikull shqyrtohet mundësia për ekzistencën e një komuniteti sigurie brenda rajonit të Ballkanit Perëndimor, duke eksploruar kontributin e policisë në Kroaci, si grup profesionistësh, në procesin e ndërtimit të një komuniteti sigurie.</p>
<p>Sandra Kobajica, Criminological characteristics of crime against the environment in Bosnia and Herzegovina, PhD dissertation [Karakteristikat kriminologjike të krimit ndaj mjedisit në Bosnjë dhe Hercegovinë: punim për titullin "Doktoreshë e shkencave"], University of Sarajevo, Faculty of Criminal Justice, Criminology and Security Studies, 2021.</p>	<p>Në këtë studim hetohen shkaqet rrënjësore dhe manifestimet e krimit mjedisor në Bosnjë dhe Hercegovinë nga një pikëpamje teorike dhe empirike. Studimi ndjek një qasje të kriminologjisë moderne të përqendruar te kriminologjia mjedisore ose "e gjelbër".</p>
<p>Danilo Mandić, Trafficking and Syrian refugee smuggling: Evidence from the Balkan route [Trafikimi dhe kontrabandimi i refugjatëve sirianë: Dëshmi nga rruga ballkanike], <i>Social Inclusion</i>, 5, 2, 28–38.</p>	<p>Në këtë artikull hetohet mënyra se si ndërveprojnë refugjatët sirianë me kontrabandistët, duke hedhur dritë mbi mënyrën se si gërshetohet kontrabandimi i qenieve njerëzore me trafikimin e qenieve njerëzore përgjatë rrugës ballkanike.</p>
<p>Davor Mikulić dhe Goran Buturac, In what measure is public finance sustainability threatened by illicit tobacco trade: The case of Western Balkan countries [Në çfarë shkalle kërcënohet qëndrueshmëria e financave publike nga tregtia e paligjshme e duhanit: Rasti i vendeve të Ballkanit Perëndimor], <i>Sustainability</i>, 12, 1, 401.</p>	<p>Në këtë studim, përlogaritet vëllimi i tregtisë së paligjshme të duhanit, duke identifikuar dhe kuantifikuar faktorët kyç që qëndrojnë pas saj, ndikimet që ajo ka në qëndrueshmërinë e financave publike dhe në intensitetin e tregtisë së duhanit në përgjithësi.</p>

<p>Valery Perry dhe Ivan Stefanovski, Sell out, tune out, get out, or freak out? Understanding corruption, state capture, radicalization, pacification, resilience, and emigration in Bosnia and Herzegovina and North Macedonia [T'i shesësh të tëra, të shpërfillësh, të ikësh apo të luash mendsh? Të kuptosh korrupsionin, kapjen e shtetit, radikalizimin, paqesimin, qëndrueshmërinë dhe emigracionin në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në Maqedoninë e Veriut], Eurothink – Center for European Strategies, 2021.</p>	<p>Në këtë nismë hulumtimi eksplorohet ajo nëse idetë e paraqitura në librin e Sarah Çajesit (Sarah Chayes) "Thieves of State: Why Corruption Threatens Global Security [Hajdutët e shtetit: Pse korrupsioni kërcënon sigurinë globale] ndihmojnë apo jo për të kuptuar dinamikat aktuale shoqërore, politike dhe ekonomike në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në Maqedoninë e Veriut.</p>
<p>Iztok Prezelj dhe Nina Otorepec Vogrinčič, Criminal and networked state capture in the Western Balkans: the case of the Zemun clan [Kapja kriminale dhe në rrjet e shtetit në Ballkanin Perëndimor: Rasti i klanit të Zemunit], Southeast European and Black Sea Studies, 20, 4, 547–570.</p>	<p>Në këtë studim, autorët argumentojnë se Ballkani Perëndimor, herë pas here, përballet me problemin e kapjes së shtetit nga rrjetet, në bazë të një lidhjeje në varg midis krimit të organizuar, biznesit, politikës, shërbimeve të sigurisë dhe gjyqësorit.</p>
<p>Branislav Radeljić dhe Vladimir Đorđević, Clientelism and the Abuse of Power in the Western Balkans [Klientelizmi dhe abuzimi me pushtetin në Ballkanin Perëndimor], Journal of Balkan and Near Eastern Studies, 22, 5, 597–612.</p>	<p>Duke pasur në fokus Serbinë dhe Kosovën, në këtë punim argumentohet se rrjetet kriminale dhe elitat politike në pushtet dhe elitat ekonomike janë bërë të pandashme, çka ndikon drejtpërdrejt te proceset e integritetit të të dy vendeve në bashkimit Evropian.</p>
<p>Ina Rama, Overview of the characteristics of the Albanian organized crime: Development trends over the years [Pasqyrë e karakteristikave të krimit të organizuar shqiptar: Zhvillimi i prirjeve ndër vite], Mediterranean Journal of Social Sciences, 12, 4, 112.</p>	<p>Në këtë punim përshkruhen disa tipare të skenës së krimit të organizuar shqiptar, konteksti i tij historik dhe evoluimi i mënyrës së organizimit të grupeve të tij dhe i tipave dhe fushave të veprimtarisë në të cilat ato përfshihen.</p>
<p>Vedran Recher, Tobacco smuggling in the Western Balkan region: Exploring habits, attitudes, and predictors of illegal tobacco demand [Kontrabandimi i duhanit në rajonin e Ballkanit Perëndimor: Shqyrtimi i zakoneve, qëndrimeve dhe faktorëve parashikues të kërkesës në tregun e paligjshëm të duhanit], The Institute of Economics, 1, 1–24.</p>	<p>Në këtë studim, trajtohet kontrabandimi i duhanit në Ballkanin Perëndimor, rajon ky famëkeq, i njohur si rruga kryesore e kontrabandimi për vendet e Evropës Perëndimore. Të dhënat përdoren si bazë për të ekspluaruar zakonet e duhanpirjes, qëndrimet lidhur me tregun e paligjshëm dhe faktorët parashikues të kërkesës në tregun e paligjshëm.</p>
<p>Věra Stojarová, Media in the Western Balkans: Who controls the past controls the future [Media në Ballkanin Perëndimor: Kush kontrollon të shkuarën, kontrollon të ardhmen], Southeast European and Black Sea Studies, 20, 1, 161–181.</p>	<p>Në artikull vlerësohet roli që luan media në Ballkanin Perëndimor në lidhje me demokratizimin dhe anëtarësimin në BE, si dhe zhvillimi afatgjatë i lirisë së medias përballë presionit ekonomik dhe politik.</p>



Të shfrytëzuar në sy të të gjithëve: Vlerësim i shfrytëzimit komercial seksual të fëmijëve dhe reagimet për mbrojtjen e fëmijëve në Ballkanin Perëndimor

Në këtë raport vlerësohet cenueshmëria e fëmijëve ndaj shfrytëzimit komercial seksual të fëmijëve (SHKSF) në të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, me fokus të veçantë në shfrytëzimin seksual në internet të fëmijëve dhe në shfrytëzimin seksual të fëmijëve në sektorin e udhëtimeve dhe turizmit. Në raport jepet edhe një pasqyrë e përgjithshme e gjërave që janë – dhe që nuk janë duke bërë – autoritetet e zbatimit të ligjit, kompanitë private dhe organizatat e shoqërisë civile për të reaguar ndaj shfaqjeve të ndryshme të SHKSF-së dhe për t'i luftuar dhe parandaluar ato.

Prurjet financiare të paligjshme në Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi dhe Serbi: Faktorët kryesorë dhe prirjet aktuale

Robin Cartwright dhe Kristina Amerhauser

Ky raport shënon përfundimin e studimit tonë të prurjeve financiare të paligjshme (PFP) në Ballkanin Perëndimor. Këtë herë, përqendrohemi te Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia. PFP-të janë mekanizma me anë të të cilëve paratë e fituara në rrugë të paligjshme transferohen drejt ekonomive dhe dalin prej tyre për të shkuar te përfituesit kriminelë kudo në botë. Çdo vit, shuma të mëdha parash transferohen jashtë ekonomive në zhvillim dhe në tranzicion. Këto fonde mund të përdoren për të mira publike dhe private: shërbime publike, investime ose hapje vendesh të reja pune. E gjithë shoqëria vuan si pasojë e humbjes së këtyre fondeve.

Mirënjohe

“Buletini i rreziqeve” është rezultat i punës së Observatorit të Ekonomive të Paligjshme në Evropën Juglindore (“SEE-Obs”) të Iniciativës Globale Kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar.

SEE-Obs-ja është platformë që bashkon dhe fuqizon aktorët e shoqërisë civile në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi. Qëllimi i platformës është t’i mundësojë shoqërisë civile të identifikojë, analizojë dhe vendosë në hartë prirjet kriminale dhe ndikimin që ato kanë në

prurjet e paligjshme financiare, qeverisje, zhvillim, marrëdhëniet ndëretnike, sigurinë dhe shtetin ligjor. SEE-Obs-ja mbështet shoqërinë civile në monitorimin që ajo u bën dinamikave kombëtare dhe prirjeve më të gjera rajonale dhe ndërkombëtare të krimin të organizuar.

Platforma “SEE-Obs” u themelua si rezultat i Samitit të vitit 2018 të Vendeve të Ballkanit në Londër, në kuadër të Procesit të Berlinit.

Përfitojmë nga rasti për të falënderuar Ivica Simonovskin për kontributet e tij të çmuara.

“Buletinet e rreziqeve” janë publikime periodike të vëzhguesve tanë rajonalë, të cilët mbështeten në rrjetet e shoqërisë civile për të siguruar të dhëna të reja dhe për të vënë në kontekst prirjet që kanë të bëjnë me rrjetet e krimit të organizuar, tregtinë e paligjshme dhe reagimin shtetëror ndaj tyre. Nëse dëshironi të abonoheni për numrat e ardhshëm të “Buletinit të rreziqeve”, ju lutemi të regjistroheni këtu ose të na dërgoni një email në adresën: almedina.dodic@globalinitiative.net.

MBI “INCIATIVËN GLOBALE”

Iniciativa Globale Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar është një rrjet mbarëbotëror, i përbërë nga 500 ekspertë nga e gjithë bota. “Iniciativa Globale” ofron një platformë për të nxitur një debat më të gjerë dhe qasje novatore, duke krijuar kështu një bazë të shëndoshë për hartimin e një strategjie globale gjithëpërfshirëse kundër krimit të organizuar.

www.globalinitiative.net

Ky botim u bë i mundur falë përkrahjes financiare të Fondit të Mbretërisë së Bashkuar për Konfliktin, Stabilitetin dhe Sigurinë. Lënda e botimit është përgjegjësi vetëm e GI-TOC-së dhe nuk pasqyron patjetër pikëpamjet e Mbretërisë së Bashkuar.



**GLOBAL
INITIATIVE**
AGAINST TRANSNATIONAL
ORGANIZED CRIME